

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

ANILA OMARI

DHORI QIRJAZI, *BLETA SHQYPTARE*, BOTIM ANASTATIK ME NJË STUDIM HYRËS

Në 200-vjetorin e lindjes së Thimi Mitkos Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka botuar në dy vëllime librin Thimi Mitko (18820-1890) “Bleta shqiptare, shkrime të tjera dhe dokumente”, përgatitur nga Dhori Q. Qirjazi, Tiranë, 2020.

Prof. Dhori Qirjazi prej vitesh i ka hyrë studimit të thelluar të veprimtarisë mbledhëse e krijuese të rilindasit të shquar Thimi Mitko, nëpërmjet shqyrtimit të dokumenteve në fondet e dedikuara të Arkivit të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë dhe të Arkivit Qendror të Shtetit, të sjella në Shqipëri në mesin e viteve '80 nga prof. Jorgo Bullo. Ky fond i pasur me dorëshkrime, i ruajtur nga pasardhësit e Mitkos në Aleksandri të Egjiptit, është një thesar i vërtetë për të hedhur dritë e për të plotësuar zbrazëtitë mbi veprimtarinë letrare të panjohur të Thimi Mitkos. Mbas një pune disavjeçare prof. Qirjazi nxori në dritë botimin e dorëshkrimit të Fjalorit shqip-greqisht e greqisht-shqip bashkë me ndihmesa të tjera leksikografike të Mitkos, duke kryer punën e imtë përgatitore të botimit të 5 mijë skedave me dorëshkrime si dhe një studim hyrës për historikun e parateksteve. Shënojmë që prof. Dhori Qirjazi është studiuesi i rrallë, në mos i vetmi albanolog në kohën e sotme, i cili ka përgatitjen dhe formimin e duhur gjuhësor e filologjik për t'u marrë me studimin, transkriptimin, përkthimin dhe përgatitjen për botim të një veprë si ajo e Mitkos, e shkruar me alfabetin grek dhe pjesërisht e shkruar në gjuhën greke.

Puna me studimin e dorëshkrimeve të Mitkos i ka hapur horizonte të reja autorit për të sjellë në vëmendjen e publikut fakte të panjohura lidhur me punën paraprake të Mitkos për realizimin e botimit të Bletës Shqiptare, me rrethanat e përgatitjes së veprës, me përmbajtjen e një versioni të parë që do të botohej në Athinë në vitin 1875 që autori e la disa kohë pa botuar për shkak të gabimeve të shumta, e me materiale të tjera me interes për figurën dhe personalitetin e Thimi Mitkos.

Saktësimet e historisë së paratekstit fillojnë që me kohën e interesimit të Mitkos për grumbullimin e materialeve folklorike, ku sipas dokumenteve të shkruara nga vetë Mitkoja si dhe të dhënave të tjera të tërthorta kjo kohë përkon me fillimin e viteve 1850, e më pas me kohën e përfundimit e dërgimit në shtyp e me peripecitë dhe kohëzgjatjen që kaloi procesi i shtypit, deri sa u botua më në fund në Aleksandri të Egjiptit në vitin 1878.

Evidentimi i pjesëve të parathënies së Mitkos është me interes për të kuptuar synimet e veprës së Mitkos për t'i ardhur në ndihmë kombit të tij shqiptar, synime që i gjejmë edhe te citimi i parathënies së rilindasit të shquar Naum Veqilharxi, dhe, do të shtonim, i gjejmë që dy shekuj më parë te autorët e vjetër si Pjetër Budi e pasardhësit e tij, pra tek të gjithë ata patriotë që u përpoqën të ndriçonin mendjen e bashkëkombasve të tyre nëpërmjet lëvrimit të gjuhës amtare, me qëllim ngritjen e ndërgjegjes kombëtare.

Studimi në përballje përmbajtjen e strukturës së Bletës së vitit 1875 sipas lëndës që kishte ndër mend të përfshinte Mitkoja, dhe veprës së botuar në vitin 1878. Me rëndësi për autorin është ideja e përfshirjes në vëllim nga Mitkoja përkthimin shqip nga Dh. Kamarda të studimit të Dora D'Istrias "Kombi shqiptar sipas këngëve popullore" të përshtatur në të folmen toskërishtedangëllishte dhe së dyti fakti që Mitkoja e ka konceptuar vëllimin e tij jo thjesht si përmbledhje materiali folklorik por si një krestomaci apo antologji që jep më të plotë figurën e shqiptarëve dhe të kombit të tyre. Për këtë model autori mendon se Mitkoja mund të ketë ndjekur traditën e Hahnit dhe të Kamardës, edhe pse fillimin e grumbullimit të lëndës duhet ta ketë nisur pa dalë në dritë ndonjëra nga këto vepra. Edhe për emërtimin *Bleta* të vëllimit, autori sqaron ekzistencën e një tradite emërtimi *Melissa* në përmbledhje të tilla antologjike greqisht, të cilën ka ndjekur Mitkoja.

Në gjurmët e hartimit të veprës së Mitkos, autori mendon se Mitkoja e ka konceptuar veprën si një botim dygjuhësh shqip-greqisht, një ide është në vazhden e botimeve dygjuhëshe që fillojnë që me librin e parë shqip, Mesharin e Gjon Buzukut, por për arsye ekonomike e ka pakësuar vëllimin e veprës duke botuar vetëm parathënien greqisht. Por me interes është shpjegimi i Mitkos për arsyen e shoqërimit të përrallave shqip me përkthimin greqisht, për t'u ardhur në ndihmë albanologëve.

Krahas ndjekjes së punës së Mitkos për botimin e veprës, dorëshkrimet e gjetura në arkiva si edhe shkrimet e botuara të Mitkos i japin mundësi autorit të hedhë dritë në mendimin politik të Mitkos dhe të ndjekë evolucionin e këtij mendimi nga viti 1874 në 1878. Mitkoja në vitin 1874, si të gjithë iluministët e atdhetarët që ëndërronin çlirimin nga sundimi osman dhe mëvetësimin e kombeve të shtypur, lëvdon dhe frymëzohet prej revolucionit grek të vitit 1821, por njëkohësisht priret nga ideja e një Konfederate ballkanike si faktor stabiliteti mes popujve të Ballkanit, ide që përkrahej edhe nga mendimtarë e atdhetarë të tjerë si Dora D'Istria, por jo nga De Rada, që kishte një vizion

tjetër për të ardhmen e vendit. Ndërsa në parathënien e botimit të vitit 1878 Mitkoja e ka nuhatur rrezikun që u kanoset shqiptarëve nga “Megali Idhea” greke. Kjo theksohet në studimin hyrës të vëllimit, por njëkohësisht vihet në dukje edhe se Mitkoja i mbetet idesë së një atdheu të përbashkët me grekët, duke u nisur dhe nga ideja e një origjine të përbashkët heleno-pellazgjike të dy popujve, mjaft e përhapur në shekullin XIX. Siç vëren autori, “me një ton dhe besim prej idealisti ai i drejtohet Greqisë dhe i kërkon t’i shohë shqiptarët “si nënë e përgjëruar” e jo “si njerjë ziliqare”.”

Një frymë të ngjashme mbi lidhjet e ngushta farefisnore shqiptaro-greke e gjejmë në mesin e shek. XIX edhe te dijetarë të tjerë shqiptarë, arbëreshë e arvanitas, si Dhimitër Kamarda, Tasos Nerucos, Jani Vreto etj., i cili më pas u bë veprimtar nga më kryesorët e Rilindjes kombëtare. Në studim theksohet rruga e njëjtë e zhvillimit të mendimit politik të Mitkos me Jani Vreton. Që në vitet e rinisë së tij, rreth fundit të viteve 1830, Mitko kopjon veprën e Danil Voskopojarit dhe fjalorin e tij katërgjuhësh, duke ndjekur rrugën e tij për t’iu kthyer greqishtes si “mëmë e dijes”. Por ndryshe nga Danili, ai nuk i fton shqiptarët të bëhen romej (= grekë), por i cilëson ata “degë elinësh”, siç del në një mbishkrim të shkruar prej tij disa vite më vonë, në 1843, me rastin e ringritjes së gjimnazit grek në Korçë. Këtu autori zbulon enigmën e një boshllëku që gjendet në mbishkrimin në pllakën përkujtimore të shkruar nga Mitko, ku mungon fjala *elinësh* dhe ka mbetur vetëm *degë*. Boshllëkun nuk e kanë vënë në dukje as riprodhuesit e mëvonshëm të mbishkrimit, H. Karmici (1888) dhe Nuçi Naçi (1901, 1923). Autori ka gjetur dy dokumente të Mitkos të vitit 1843, njëri nga të cilët është kopje e mbishkrimit në gur të shkollës, ku del se Mitko i ka quajtur bashkëqytetarët e vet degë helenësh, duke i ftuar ata të tregojnë zell në të mësuar e t’i imitojnë ata në dituri. Këto ide autori i gjen edhe te dijetarë të tjerë të asaj kohe, që i mbajnë shqiptarët për degë helenësh dhe nga ana tjetër interesohen për lëvrimin e shqipes e për alfabetin e saj. Autori thekson zhvillimin jo të njëtrajtshëm të idesë kombëtare te shqiptarët duke sjellë shembullin e rilindasit më të hershëm, Naum Veqilharxhit, i cili nga pjesëmarrës i revolucionit grek dhe anëtar i Filiqi Eterias, u bë luftëtar për çështjen e kombit dhe të gjuhës së shqiptarëve.

Autori argumenton se teoria e rrënjëve të përbashkëta pellazgjike të shqiptarëve dhe grekëve që ishte përhapur rreth mesit të shekullit XIX u shkonte për shtat shqiptarëve dhe u shërbente synimeve të tyre kombëtare që në atë kohë ishin në formim e sipër. Por u shkonte për shtat edhe grekëve, pasi shqiptarët në Greqi ishin të pranishëm gjerësisht në territoret greke dhe në vetë rrethinat e kryeqytetit grek, por sidomos për shkak të pjesëmarrjes së tyre vendimtare në revolucionin çlirimtar grek të 1821-shit që shënoi një lidhje të ngushtë të dy popujve, kur për më tepër ekzistonte siguria se shqiptarët shpejt a vonë do të helenizoheshin. Jo rastësisht, thotë autori, Megali Idhea u shfaq në të njëjtën kohë me teorinë pellazgjike. Gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve, 1846-

1880, të pasur me ngjarje që sollën maturimin e lëvizjes kombëtare shqiptare, u zhvillua edhe mendimi politik i personaliteteve të kësaj lëvizjeje, siç qe edhe Mitko, që shkoi nga idealizmi i fillimit të realizmi politik i fundit të shek. XIX që kulmoi me traktatet e vëllezërve Frashëri “Dëshira e vërtetë e Shqiptarëve” dhe “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Evolucionin e Mitkos autori e shpreh nëpërmjet fjalëve shumë të qarta të Nuçi Naçit me rastin e botimit të mbishkrimit të shkollës greke të vitit 1843: “atëhere [më 1843] Grekoman i fortë, dhe më pas Shqipëtar i flaktë”. Siç është e logjikshme, dhe në pikëpamjen e autorit, rrethanat e mesit të shekullit XIX duhen vështruar e vlerësuar në kohën dhe kontekstin historik përkatës dhe jo sipas interpretimeve dhe këndvështrimeve të sotme të shteteve kombëtare dhe identiteve të formuara nacionale.

Procesin gradual të pjekjes së mendimit politik shqiptar autori e ilustron edhe me dy dokumente të tjera, ku i pari është i vitit 1860 i shkruar nga krerët e bashkësisë ortodokse të Korçës, të cilët kërkonin libra greqisht për bibliotekën e qyteti, duke e konsideruar kombin shqiptar të njëjtë me kombin grek, dhe i dyti nga banorët ortodoksë të këtij qyteti drejtuar pleqësisë kishtarë në vitin 1914 ku kërkohet të këndohet mesha në gjuhën amtare.

Autori përmes dokumenteve hedh dritë edhe mbi procesin e botimit e të qarkullimit të veprës së Mitkos, lidhur me sigurimin e burimeve financiare nëpërmjet pajtimtarëve të regjistruar me emrat e tyre në faqet e fundit të botimit të 1878-s. Ai jep në mënyrë tabelare shpërndarjen gjeografike dhe numrin e pajtimtarëve, si dhe kopjet e porositura nga secili prej tyre, gjithsej një numër i konsiderueshëm prej 451 kopjesh të librit, duke u ndalur në emra të njohur personazhesh të kohës, në shpërndarjen krahinore si dhe në atë fetarë të abonentëve.

Dokumentet flasin edhe për vështirësitë e ndryshme që përjetoj Mitko në botimin e veprës së tij, që nga ato teknike, por sidomos pengesat e natyrës politike, siç janë kritikata nga ana e filohelenëve për rrezikun që paraqiste vepra ndaj interesave të helenizmës, por edhe mosmarrëveshjet me patriotët e tjerë shqiptarë për çështjen e alfabetit të veprës. Me këtë rast sillet në studim një letër e Jani Vretos, përndryshe mik i ngushtë i Mitkos, i cili nuk është dakord me alfabetin e përdorur nga Mitkoja.

Në studim vihet në dukje edhe aktiviteti i gjallë i Mitkos për marrëdhënie me atdhetarë e dijetarë shqiptarë e albanologë të huaj nëpër botë përmes letërkëmbimit të tij, madje edhe lidhjet që krijonte Mitkoja mes këtyre figurave me njëri-tjetrin. Mitkoja merr ide prej këtyre dijetarëve, me të cilat brumos veprën e tij, por edhe jep me bujari lëndë folklorike e materiale të ndryshme albanologëve si Gustav Meyeri. Ndër këto letërkëmbime është me interes gjetja e njërit nga variantet e parathënies së Bletës, të kopjuar në të pastër nga një dorë e ndryshme nga ajo e Mitkos, që autori zbulon se është dora e Tasos Nerucos, dijetar dhe mik i Mitkos.

Dokumente të tjera të Arkivit hedhin dritë mbi punën e mëtejshme përgatitore të Mitkos për botimin e një vëllimi të dytë me lëndë folklorike, siç është dokumenti i vitit 1885 që përmban përshkrimin prej Mitkos të lëndës që është dërguar për botim dhe që do të përbënte vëllimin e dytë të Bletës. Dokumenti riprodhohet i transkriptuar në gjuhën greke dhe i përkthyer në shqip, meqenëse paraqet interes për përmbajtjen e tij. Këtë dokument autori e krahason me letërkëmbimin e Mitkos me Gustav Meyerin, i cili i kishte premtuar atij t'i botonte këtë vepër, që do të ishte në vëllim disi më e gjerë se Bleta Shqiptare. Por me kalimin e kohës Mitkoja u zhgënjye nga mosmbajtja e premtimit dhe kërkoi më në fund që t'i ktheheshin dorëshkrimet.

Fakti që Mitko e pohon se i janë kthyer dorëshkrimet, e nxit autorin të hedhë në letër e të bëjë të njohur për publikun të dhënat që ekzistojnë deri tani dhe rrugët që duhen ndjekur për të kërkuar më tej këto fletore të Mitkos që përmbajnë lëndën e vëllimit të dytë të Bletës. Për këtë propozon hartimin e një projekti të gjerë të botimit integral të trashëgimisë së Mitkos për kërkime në disa arkiva të vendeve të ndryshme dhe për mbledhjen e materialeve të botuara në gazeta të ndryshme, shkrime e vepërza apo përkthime, e gjithë çka tjetër mund të mblidhet për t'u plotësuar vepra e këtij atdhetari e iluministi të shquar shqiptar.

Vepra përmban dokumente të panjohura deri tani që lidhen me botimin e Bletës Shqiptare të Thimi Mitkos, të riprodhuara në mënyrë fototipike, në transkriptimin e tyre në gjuhën greke dhe në përkthimin shqip, një punë e imtë e skrupuloze që e karakterizon autorin në punët e tij filologjike. Një vëllim më vete përbëjnë botimi anastatik i Bletës Shqiptare të vitit 1878 si dhe Bleta e botuar nga Gjergj Pekmezi në vitin 1924 me gjithë shënimin hyrës të tij, vepra që sot janë bërë një rrallësi për publikun. Të gjitha këto pjesë përbërëse të veprës së Mitkos dalin në dritë pas afro 150 vjetësh, bashkë me studimin shoqëruar të botuesit të tyre, prof. dr. Dhori Qirjazit.

